



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E LIPJANIT

Departamenti i Prokurimit

Komuna e Lipjanit: datë, 13/04/2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 12/04/2022 të parashtruar nga *Grupi Operatorëve ekonomik D A GREEN SH.P.K.; AROMA PLUS SH.P.K.*, Isa Olluri b6, 14000, Lipjan, Kosovë., lidhur me aktivitetin e prokurimit: Mirëmbajtja dhe pastrimi i objekteve Komunale. me numër identifikues: **613-21-1384-2-2-1**, Nr i brendshëm **613 022 025 221**.

VENDIM

Refuzohet kërkesa për rishqyrtim, e parashtruar *Grupi Operatorëve ekonomik D A GREEN SH.P.K.; AROMA PLUS SH.P.K.*, Isa Olluri b6, 14000, Lipjan, Kosovë., lidhur me aktivitetin e prokurimit: Mirëmbajtja dhe pastrimi i objekteve Komunale me numër identifikues: **613-21-1384-2-2-1** Nr i brendshëm **613 022 025 221**.

Vërtetohet Vendimi i AK për anulimin e aktivitetit të prokurimit, të publikuar me datë: **06/04/2022**. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Grupi Operatorëve ekonomik D A GREEN SH.P.K.; AROMA PLUS SH.P.K., Isa Olluri b6, 14000, Lipjan, Kosovë., më datë 11/04/2022: ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim për tenderin me titull: "Mirëmbajtja dhe pastrimi i objekteve Komunale. me numër identifikues: **613-21-1384-2-2-1** Nr i brendshëm **613 022 025 221**, Autoriteti Kontraktues, me datë 13.04.2022, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimet e ankuesit janë të pa bazuar :

Gjatë vlersimit komisioni vlerësues ka konstatuar se te përshkrimi i çmimit është një gabim te kolona e për çmimin për njësi është paraqitur shuma totale për një muaj, kjo nuk përkon me gjendjeën faktike pasi që tek çmimi për njësi për m2, është dashtur të kalkulohet 5000 x çmimi me TVSH për njësi për çdo muaj, ndersa ju keni vendosur çmimin për muaj dhe kjo shkakton konfuzion tek vlerësimi dhe tek procedurat e mëvonshme dhe si e tillë paramasa ka krijuar konfuzion te shumë tenderues.

Nr. I art	Përshkrimi i objekteve që do të mirëmbahen	Njësia	Sasia	Çmimi me TSVH per njësi për 1 muaj	Shuma Totale me TVSH për 36 muaj
1	Ndërtesa e Komunës	m ²	5000		
2	Qendra për punë sociale	m ²	340		
3	Salla e kinofilmit e cila gjendet në shtëpia e kulturës “ Tahir Sinani”	m ²	550		
4	Arkivi Historik i Qytetit të Lipjanit	m ²	1350		
5	Oborri i Komunës	m ²	1200		
6	Zyret e vendit te gjendjes Civile ne disa lokalitet Shalë 64 m ² , Janjevë 28 m ² , Gadime 77 m ² , Kraishtë 44 m ² , Magure 1= 35 m ² , Magure 2 = 25 m ²	m ²	273		
	Shuma e përgjithëshme për një muaj				
	Gjithsej shuma (për 36 muaj)				

Oferta e juaj është me gabim aritmetik mbi 9690.1% sepse pas llogaritjes aritmetikore shuma e përgjithshme e ofertës tuaj për 36 muaj është 9382295.15€, ndërsa shuma e shërbimeve që ka kërkuar Autoriteti kontraktues në bazë të çmimeve njësi që ju i keni ofruar do të ishte 260619.30€, shih tabelen pas llogaritjes aritmetikore nga komisioni vlerësues.

Nr. I	Përshkrimi i objekteve që do të mirëmbahen	Njësia	Sasia	Çmimi me TSVH per njësi për 1 muaj	Shuma Totale me TVSH për 36 muaj
1	Ndërtesa e Komunës	m ²	5000	1700	8500000
2	Qendra për punë sociale	m ²	340	119	40460
3	Salla e kinofilmit e cila gjendet në shtëpia e kulturës “ Tahir Sinani”	m ²	550	192.5	105875
4	Arkivi Historik i Qytetit të Lipjanit	m ²	1350	472.5	637875
5	Oborri i Komunës	m ²	1200	60	72000
6	Zyret e vendit te gjendjes Civile ne disa lokalitet si: Shalë 64 m ² , Janjevë 28 m ² , Gadime 77 m ² , Kraishtë 44 m ² , Magure 1= 35 m ² , Magure 2 = 25 m ²	m ²	273	95.55	26085.15
	Shuma e përgjithshme për një muaj				260619.3097
	Gjithsej shuma (për 36 muaj)				9382295.15

Nr. i Art.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Shuma me TVSH për 1 sezonë	Shuma me TVSH për 3 sezona
1	Mbjellja e fidaneve-luleve	copë	1500	15	45.00
	Shuma e përgjithëshme				45.00


Nr.	Përshkrimi	Shuma totale me TVSH
1	Tabela I	9382295.15
2	Tabela II	45.00
	Shuma e përgjithëshme me TVSH	9382340.15

Kështu që duke i pare këto defekte në përshkrimin të çmimeve komisioni vlerësues ka rekomanduar për anulim të kësaj procedure.

Andaj duke u bazuar nga ajo që u tha më lartë Zyrtari Përgjegjës i prokurimit ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorezohet brenda 10 (dhjete) ditëve pas pranimi të këtij vendimi.

Bekim Shabani

Drejtore i drejtorisë së Prokurimit